

RREGULLAT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË “KLINIKAVE ACIBADEM”

Përkufizimet Zyrtare

Banka – person juridik, i cili, në bazë të licencës përkatëse bankare, ka të drejtën ekskluzive për të ofruar shërbime bankare në territorin përkatës të: Azerbajxhanit, Kazakistanit, Uzbekistanit, Kirgistanit, Takhikistanit, Turkmenistanit, Bjellorusisë, Moldavisë, Ukrainës, Gjeorgjisë, Serbisë, Bosnjë Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Kosovës dhe Shqipërisë.

Partner Teknik – “INFOCUS” LLC, kodi i identifikimit të personit juridik (NIPT): 36563986, me seli në Ukrainë, 01023, Kiev, Sheshi Sportyvna nr. 1A.

Mbajtësit e Kartave – të gjithë individët, mbajtës të kartave të regjistruara në Chatbot, të cilët kanë të drejtë të përfitojnë nga Shërbimet në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave.

Karta – kartë pagese Visa, e lëshuar nga Banka.

Konsumatori – Visa International Service Association, me seli në SHBA, CA 94404–2775, Foster City, Bulevardi Metro Center, nr. 900.

Messenger – aplikacion celular për dërgim të menjëhershëm mesazhesh dhe videosh, përfshirë Telegram-in.

Kontraktuesi – ACIBADEM HEALTHCARE GROUP, person juridik me kod identifikimi (NIPT): 3890729631, vendndodhja: GC Yeme İçme Hizmetleri A.Ş.

Shërbimi – shërbim kontrolli mjekësor i ofruar nga Kontraktuesi, në përputhje me përshkrimin e treguar në faqen e internetit: <https://acibademinternational.com/>

Privilegji – zbritje prej 15%, e cila ofrohet në përputhje me kushtet e këtyre Rregullave gjatë pagesës për shpenzime mjekësore, përfshirë konsultat mjekësore, analizat laboratorike, ekzaminimet radiologjike, operacionet dhe kontrollet shëndetësore, në spitalet e Kontraktuesit në Turqi, duke përdorur Kartën. Pagesa kryhet vetëm në arkën e Kontraktuesit duke përdorur Kartën (pagesa me Kartë konsiderohet pagesë me kartë plastike, duke përdorur teknologjinë NFC).

Rregullat – këto rregulla për ofrimin e shërbimeve të “Klinikave Acibadem”.

Afati i vlefshmërisë – periudha nga 10.08.2024 deri më 31.05.2026, nëse nuk përcaktohet një afat tjetër nga Konsumatori.

Chatbot – chatbot-i i disponueshëm përmes këtij link-u: <https://t.me/VisaConciergeBot>

Të gjitha termat e tjera që nuk kanë përkufizim të përcaktuar në këto Rregulla kanë kuptimin e përcaktuar nga dispozitat e legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

1. Si të përfitoni Privilegjin

1.1. Për të përfituar Privilegjin, Mbajtësi i Kartës duhet të kryejë veprimet e mëposhtme:

1.1.1. të jetë Mbajtës i vlefshëm i Kartës;

1.1.2. të jetë i regjistruar ose të regjistrohet në Chatbot, në përputhje me mekanizmin e brendshëm të regjistrimit të përfshirë në Chatbot;

1.1.3. të hyjë në menunë “Health and Care”;

1.1.4. të njihet me këto Rregulla;

1.1.5. të pranojë këto Rregulla;

1.1.6. të zgjedhë një nga opsionet e mëposhtme:

1.1.6.1. 15% zbritje për kontrollat mjekësore (Check-up). Duke zgjedhur këtë opsion, Mbajtësi i Kartës mund të përfitojë Shërbimin. Mbajtësi i Kartës mund t'i japë autorizim Partnerit Teknik për të caktuar një takim për Shërbimin përkatës, duke përcaktuar emrin, mbiemrin, datën, orën, klinikën dhe numrin e telefonit të kontaktit për takimin.

1.1.6.2. Shërbime mjekësore. Duke zgjedhur këtë opsion, Mbajtësit të Kartës i vihen në dispozicion të dhënat e klinikave të Kontraktuesit për regjistrim të pavarur në Privilegjet përkatëse.

1.2. Këto Rregulla përbëjnë dokumentin kryesor në marrëdhëniet ndërmjet Mbajtësit të Kartës dhe Partnerit Teknik / Konsumatorit / Kontraktuesit. Kontraktuesi mund të ketë rregulla/kushte shtesë për ofrimin e Shërbimeve, të cilat, gjithsesi, nuk duhet të jenë në kundërshtim me këto Rregulla. Mbajtësi i Kartës i pranon në mënyrë të pavarur këto rregulla/kushte dhe i merr përsipër vetë pasojat që burojnë nga ky pranim.

1.3. Pranimi nga ana e Mbajtësit të Kartës kryhet në mënyrë vullnetare dhe përbën lidhjen e një marrëveshjeje me shkrim në përputhje me kushtet e përcaktuara në këto Rregulla.

2. Si të përfitoni Shërbimet, kufizimet e Shërbimit dhe Privilegjet

2.1. Privilegji dhe Shërbimi nuk mund të kombinohen me zbritje apo fushata të tjera promotionale. Privilegji dhe Shërbimi nuk zbatohen për mbulimin e sigurimit. Privilegji dhe Shërbimi nuk vlejnë për promovime apo marrëveshje korporative. Privilegji dhe Shërbimi nuk mund të përfitohen dhe as të aplikohen pas kryerjes së pagesës.

2.2. Kontraktuesi rezervon të drejtën të anulojë çdo Privilegj ose Shërbim, me aprovimin e Konsumatorit, pa njoftim paraprak, në rastet e keqpërdorimit apo mashtrimit.

2.3. Nuk do të ofrohet asnjë kompensim monetar për asnjë Privilegj apo Shërbim që nuk është marrë.

3. Përgjegjësia e Palëve

3.1. Të gjitha ankesat duhet të paraqiten nga Mbajtësi i Kartës drejtpërdrejt tek Kontraktuesi. Mbajtësi i Kartës nuk mund të paraqesë ankesa tek Konsumatori, Banka apo Partneri Teknik.

3.2. Pa paragjykuar asnjë nga dispozitat e mësipërme dhe jo me qëllim të shmangies së zbatimit të dispozitave ligjore, Konsumatori dhe/ose Partneri Teknik dhe/ose Banka nuk mbajnë përgjegjësi për asnjë dëm të shkaktuar ndaj asnjë pasurie apo personi, ose nëse Shërbimet apo Privilegjet nuk përmbushin pritshmëritë e Mbajtësit të Kartës apo palëve të treta.

3.3. Partneri Teknik dhe/ose Konsumatori dhe/ose Banka nuk mbajnë përgjegjësi për objektin, cilësinë, sasinë dhe afatin e ofrimit të Shërbimeve dhe Privilegjeve nga Kontraktuesi, për shkak të pamundësisë për të përdorur Shërbimin (duke përfshirë mungesën e orareve të lira për regjistrim).

4. Dispozita të Ndryshme

4.1. Partneri Teknik ka të drejtë të përfshijë palë të treta për përmbushjen e detyrimeve sipas këtyre Rregullave.

4.2. Në rast të interpretimit të paqartë të këtyre Rregullave, si dhe për çështje që nuk rregullohen nga

këto Rregulla, Konsumatori rezervon të drejtën për t'i zgjidhur këto çështje në mënyrë të pavarur.

4.3. Partneri Teknik dhe/ose Konsumatori rezervon të drejtën për të ndryshuar Rregullat. Në këtë rast, njoftimi do të bëhet përmes publikimit në Chatbot. Këto ndryshime hyjnë në fuqi nga momenti i publikimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga vetë këto ndryshime.

4.4. Pagesa e taksave, tarifave dhe pagesave të tjera të detyrueshme kryhet nga personi i cili ka detyrimin sipas sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

4.5. Gjatë porositjes së Shërbimeve ose Privilegjeve, Mbajtësi i Kartës u rekomandohet të lexojnë me kujdes rregullat për përfitimin e Shërbimit ose Privilegjit dhe të marrin në konsideratë të gjitha kushtet përkatëse (zgjedhjen e laboratorit/klinikës, afatet e zbatimit sipas rregulloreve të brendshme të institucionit mjekësor, rekomandimet për përgatitje për ndërhyrje, etj.). Shërbimet mjekësore ofrohen ekskluzivisht në përputhje me rregullat/rregulloret e brendshme të institucionit mjekësor, mbi të cilat Konsumatori, Partneri Teknik dhe Banka nuk kanë ndikim.

5. Të Dhënat Personale

5.1. Të dhënat personale, si dhe te dhenat qe i transferohen Partnerit Teknik, përbëjnë informacion me akses të kufizuar, duke përfshirë të dhënat shëndetësore, të cilat mbulohen nga garancitë e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit në fuqi të Ukrainës, në veçanti: Ligji i Ukrainës “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Kodi Civil i Ukrainës, si dhe akte të tjera nënligjore.

5.2. Me pranimin e këtyre Rregullave, Mbajtësi i Kartës shpreh miratimin për përpunimin e të dhënave të tij/saj personale nga Partneri Teknik, përfshirë të dhënat shëndetësore, pa kufizime apo rezerva, dhe konfirmon se, duke dhënë një aprovim të tillë, ai/ajo ka lirinë e veprimit, me vullnetin e tij/saj të plotë dhe në interesin e tij/saj. Miratimi për përpunimin e të dhënave personale jepet me qëllim përfitimin e Shërbimeve dhe Privilegjeve.

5.3. Lista e të dhënave personale: mbiemri, emri, numri i telefonit, si dhe të dhëna të tjera të marra, përfshirë të dhënat shëndetësore të përcaktuara në këto Rregulla (nëse është e nevojshme).

5.4. Mbajtësi i Kartës jep miratimin për veprimet e mëposhtme mbi të gjitha të dhënat personale të përcaktuara: mbledhjen, sistemimin, grumbullimin, ruajtjen, transferimin, sqarimin (përditësimin ose ndryshimin), përdorimin, fshirjen, si dhe çdo veprim tjetër me të dhënat personale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përpunimi i të dhënave mund të kryhet si me mjete të automatizuara, ashtu edhe pa to (në rast përpunimi jo të automatizuar). Gjatë përpunimit të të dhënave personale, Partneri Teknik nuk kufizohet në përdorimin e metodave të përpunimit.

5.5. Mbajtësi i Kartës njeh dhe konfirmon se, nëse është e nevojshme, Partneri Teknik ka të drejtë t'i japë të dhënat personale palëve të treta vetëm për qëllimin e ofrimit të Shërbimeve dhe Privilegjeve (në veçanti, Kontraktuesit, si dhe një pale të tretë të huaj që ofron shërbimin e ruajtjes së të dhënave për Partnerin Teknik). Këto palë të treta kanë të drejtë të përpunojnë të dhëna personale bazuar në këtë aprovim.

5.6. Ky miratimi mbetet i vlefshëm deri në momentin e tërheqjes, përmes dërgimit të një mesazhi të Partneri Teknik në Chatbot. Në rast të marrjes së një deklarate me shkrim për tërheqjen e aprovimit, Partneri Teknik është i detyruar të ndalojë përpunimin dhe të fshijë të dhënat personale nga baza e të dhënave, përfshirë atë elektronike.

5.7. Në rast mospranimi të kushteve të Rregullave, Mbajtësi i Kartës nuk mund të përfitojë Shërbimin dhe Privilegjin.

5.8. Këto rregulla për përpunimin e të dhënave personale janë pjesë e politikës së përpunimit të të dhënave personale të përfshira në Chatbot.

5.9. Partneri Teknik nuk verifikon vërtetësinë e të dhënave personale të ofruara, duke supozuar se Mbajtësi i Kartave veprojnë me mirëbesim dhe i mbajnë të dhënat e tyre personale të përditësuara.

Partneri Teknik nuk mban përgjegjësi për dorëzimin vullnetar të informacionit të kontaktit nga ana e Mbajtësit të Kartës.

5.10. Përpunimi i të dhënave personale kryhet pa kufizim kohor, me çdo mjet ligjor, përfshirë përmes sistemeve të informacionit të të dhënave personale duke përdorur ose jo mjete të automatizuara – deri në arritjen e qëllimit të përpunimit të të dhënave personale.